

LIGJ
Nr. 156/2020

**PËR FALJEN E DETYRIMEVE TË USHTARAKËVE NDAJ FONDIT TË
SIGURIMEVE SHOQËRORE, TË KRIJUARA SI DIFERENCË NGA
RISHQYRTIMI I PENSIONEVE TË PARAKOHSHME PËR VJETËRSI SHËRBIMI,
TË CAKTUARA SIPAS VENDIMEVE GJYQËSORE TË FORMËS SË PRERË,
BAZUAR NË KRITERET E VENDIMIT UNIFIKUES TË KOLEGJEVE TË
BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË NR. 3, DATË 24.11.2016**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

1. Falen detyrimet e ushtarakëve ndaj fondit të sigurimeve shoqërore, të krijuara si diferencë nga rishqyrtimi i pensioneve të parakohshme për vjetërsi shërbimi, të caktuara sipas vendimeve gjyqësore të formës së prerë, bazuar në kriteret e vendimit unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 3, datë 24.11.2016.

2. Shumat e detyrimeve, të përcaktuara sipas pikës 1 të këtij neni, falen sipas gjendjes së mbetur në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 2

Instituti i Sigurimeve Shoqërore të ndjekë procedurat administrative e ligjore për tërheqjen e rekurseve/ankimeve pranë gjykatave përkatëse, me objekt zbatimin e nenit 1 të këtij ligji.

Neni 3

Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij ligji.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 17.12.2020.

**Shpallur me dekretin nr.11894 , datë 5.1.2021 , të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Ilir Meta.**